



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE**

Nr. _____ Prot

Shkodër, më

_____._____.2020

Lënda: Dërgohet formulari i njoftimit të fituesit (Kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin)

AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK

Pranë Këshillit të Ministrave, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Adresa: Bashkia Shkodër L."Vasil Shanto", Rr."13 Dhjetori", tel+35522400150.

Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur (prokurim publik me mjete elektronike).

Objekti i prokurimit (nqs ka lotë i ndarë sipas lotëve:"**Projektim për objektet:Rikonstruksion/ rikualifikim rrugë qytet dhe NJ.A"- Rikonstruksion rrugë qytet, Lagjja 4 (Faza I)**".

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-54311-03-12-2020**

Fondi limit: **1,202,164** (një milion e dyqind e dy mije e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkisë sipas VKB nr. 26, dt. 30.12.2019"Per miratimin e Buxhetit te vitit 2020 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2020-2022 te Bashkise Shkoder" për investime

Vlera e shpallur fituese (nqs ka lotë e ndarë sipas loteve): **1,004,087** leke pa tvsh

Data e zhvillimit të tenderit: data **10.04.2020 ora 14.00**.

Vendi: Njesia e Prokurimeve Publike, Bashkia Shkodër.

Operatori/ret e shpallur fitues sipas loteve: "**Tower**" **sh.p.k.** Adresa: Njësia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9 - Tirane, NUIS L21717003H.

KRYETAR

Voltana Ademi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
NJËSIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 07/05/2020

Nga: Bashkia Shkodër. Adresa: L."Vasil Shanto", Rr."13 Dhjetori", Tel & Fax +35522400150.

Për: "Tower" sh.p.k. Adresa: Njësia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9 - Tirane, NUIS L21717003H.

- Proçedura e prokurimit: E hapur.

- Përshkrim i shkurtër i kontratës: **Projektim për objektet: Rikonstruksion/ rikualifikim rrugë qytet dhe NJ.A"- Rikonstruksion rrugë qytet, Lagjja 4 (Faza I)**

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-54311-03-12-2020**

Fondi limit: 1,202,164 (një milion e dyqind e dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH

Burimi i Financimit: Buxheti i Bashkise viti 2020.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme

-Afati i përfundimit të shërbimit: **60 (gjashtëdhjetë) dite.**

-Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike datë **17.03.2020 nr. 12**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **10.04.2020, ora 14.00**

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1-Operatori ekonomik "Derbi - E" sh.p.k me administrator z.Bexhet Dedja, NUIS K77916947A.

Vlera **1,034,803** (Një milion e tridhjetë e katër mijë e tetëqind e tre) lekë pa tvsh.

2-Operatori ekonomik "HE & SK 11" sh.p.k. me administrator z. Festim Bregasi, L19008502B.

Vlera **1,083,202** (Një milion e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dy) lekë pa tvsh.

3-Operatori ekonomik "InfraKonsult" sh.p.k me administrator z. Redi Struga me NIPT L21512022F.

Vlera **1,176,000** (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë) leke pa tvsh

4-Operatori ekonomik "Instituti Dekliada ALB "sh.p.k NUIS K71606006A perfaqesuar

me administrator z. Devis Hasalami.

Vlera **912,596** (nëntëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë) leke pa tvsh.

5-Operatori ekonomik "LENI ING" sh.p.k me administrator z. Nikoll Paluca, NUIS J88730334W.

Vlera **1,012,191** (një milion e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e një) leke pa tvsh.

6-Operatori ekonomik "NOVATECH STUDIO" sh.p.k me administrator z. Emil Nova NUIS L 01717030 C.

Vlera **1,032,882** (një milion e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) leke pa tvsh.

7-Operatori ekonomik "SPHAERA" sh.p.k me administrator z. Ajkid Topore NUIS J81809003B.

Vlera **1,099,000** (Një milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë) leke pa tvsh.

8-Operatori ekonomik "Studio Services K-SA" sh.p.k. me administrator z. Kamerion Salillari, NUIS L71305518R.

Vlera **1,005,087** (një milion e pesëmijë e tetëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh.

9-Operatori ekonomik "TOWER" sh.p.k me administrator z. Irdi Kulla NUIS L21717003H.

Vlera **1,004,087** (një milion e katërmijë e tetëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh.

10-Operatori ekonomik "Viante Konstruksion" sh.p.k me administrator z. Gjergji Bezati NUIS K47103804L.

Vlera **1,095,253** (një milion e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e tre) leke pa tvsh.

Ka ofertues te skualifikuar.

1-U skualifikua operatori ekonomik "HE&SK" sh.p.k. për këto arsye:

- Oferta juaj nuk eshte detajuar sipas shtojces nr.11.

2-U skualifikua operatori ekonomik "Studio K-SA" sh.p.k. për këto arsye:

- Vertetimi leshuar nga OSHEE eshte ne emer te nje shoqerie tjeter
- Te gjitha shtojcat e paraqitura jane te vulosura me vule elektronike dhe jo firmosura dhe vulosura me vulen e shoqerise.
- Te gjitha shtojcat e paraqitura kane kane me shume se nje objekt prokurimi dhe kjo procedure prokurimi nuk eshte e ndare ne lote por ka objekt te vecante prokurimi.
- Mungon pagesa e detyrimeve te sigurimeve shoqerore per muajin shkurt 2020 ne vertetimin e paraqitur nga ana juaj.
- Nuk keni paraqitur sherbime te ngjashme me objektin e prokurimit.
- Mungon licenca e inxhinierit per piken Projektues të sinjalizimit rrugor me Kat11/a (sinjalistike jo ndricuese ne rruge lokale, rruge urbane dytesore dhe rruge interurbane dytesore dhe sheshe e parkime)

3-U skualifikua operatori ekonomik ”

Instituti Dekliada ALB” sh.p.k. për këto arsye:

- Oferta juaj nuk është detajuar sipas shtojces nr.11.
- Nuk plotësoni pikën 7, kapaciteti teknik të DST ”Operatori ekonomik ofertues në përlllogaritjen e ofertës duhet të referohet njoftimit të bërë me Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjencisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”. Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet të jetë brenda kufijve të vlerës minimale dhe maksimale të lejuar në kuptim të nenit 7/1 të VKM nr 354, datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

4-U skualifikua operatori ekonomik ”LENI – ING ”sh.p.k. për këto arsye:

- Oferta juaj nuk është detajuar sipas shtojces nr.11.

5-U skualifikua operatori ekonomik ”DERBI - E” sh.p.k. për këto arsye:

- Oferta juaj nuk është detajuar sipas shtojces nr.11.

6-U skualifikua operatori ekonomik ”SPHAERA” sh.p.k. për këto arsye:

- Afati i emerimit të administratorit A.T ka mbaruar me datë 03.04.2020 ndërkohë që procedura e prokurimit është hapur me datë 06.04.2020.
- Referuar vërtetimit për pagesën e sigurimeve shëndetësore keni gjobë në masën 10.000 lekë.
- Oferta juaj nuk është detajuar sipas shtojcës nr. 11.

*Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: ”TOWER” sh.p.k me administrator z. Irdi Kulla NUIS L21717003H. Njësia Bashkiake nr.2, rruga Fadil Rada, pallati Daniela, shkalla 2, kati 3, apartamenti 9 - Tirane se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **1,004,087** (Një milion e katërmijë e tetëdhjetë e shtatë) leke pa tvsh. është identifikuar si oferta e suksesshme.*

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Njësise së Prokurimeve Publike, Bashkia Shkodër, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pese) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi. Gjithashtu duhet të paraqitni të gjithë dokumentacionin e hedhur në tender origjinal ose kopje të noterizuar, të numerizuar dhe të inventarizuar.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të

konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar), siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 21.04.2020.

Ankesa: Nuk ka patur

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

VOLTANA ADEMI